



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës

DREJTORIA LIGJORE

PROJEKTVENDIM

NR. _____, DATË ____ / ____ / 2025

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN PËRFUNDIMTAR TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE TEK BASHKIA Durrës, PËR
NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b" dhe nënpika 1.2, shkronjat "a" dhe "c", nenit 23, pika 14, nenit 28, nenit 54, pika 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, nenit 3, të ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, VKM-në nr.538, datë 07.8.2012, "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Manëz, të Qarkut të Durrësit", nenit 36, 37, 38, si dhe nenit 39, pika "1.b", të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 27.01.2023, "Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve", Vendimit nr. 500, datë 14.08.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, Udhëzimit nr. 15, datë 30.06.2003, të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, "Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike", VKM-së nr. 669, datë 07.8.2013, "Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH) si metadatë", i ndryshuar, VKM-së nr. 782, datë 07.10.2020, "Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtjen e hartës kadastrale", sipas relacionit të përgatitur nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, kryetari i bashkisë, i propozon këshillit bashkiak,

PËR TË VENDOSUR:

1. Miratimin e kërkesës për transferimin përfundimtar të pronës me nr. Pasurie 67, të pasurisë me nr. 66/22; të pasurisë me nr. 287, ZK 2590, të pasurisë nr. 75; të pasurisë nr. 77/7; të pasurisë nr. 156, ZK 2065 nga shteti në pronësi të Bashkisë Durrës, për Njësinë


- Administrative Manëz, sipas lidhjes 01 bashkëlidhur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Miratimin e përditësimit të pronës me nr. liste të transferimit 50 dhe 52, miratuar me VKM nr.538, datë 07.8.2012, që përfshinë Pasurinë me nr. 67, ZK 2590 dhe 75, ZK 2065, për shkak se gjendja reale (faktike) e pronës, ku përfshihen sipërfaqja, pozicioni, konfigurimi dhe karakteristikat e tjera fizike, nuk përputhen me dokumentacionin e inventarizimit, miratuar me VKM nr. 538, datë 07.8.2012.
 3. Miratimin e plan rilevimit të pronës me emërtimin "Varreza", si dhe të pronave që kërkohet transferim nga shteti tek Bashkia Durrës, për Njësinë Administrative Manëz, sipas pikës 1, i hartuar sipas kërkesave të VKM-së nr.782, datë 07.10.2020, "Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale", bashkëlidhur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 4. Ngarkohen Drejtoria Ligjore dhe Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE


Alnelda Rroshi

KRYETAR


Emiriana Sako

Lidhja 1

Bashkia Durrës, Njësia Administrative Manëz

Numri rendor i pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1844	Prona që përdoren për shërbim funeral	Në pronësi
1845	Prona që përdoren për shërbim funeral	Në pronësi
1846	Prona që përdoren për shërbim funeral	Në pronësi
1847	Prona që përdoren për shërbim funeral	Në pronësi
1848	Prona që përdoren për shërbim funeral	Në pronësi
1849	Prona që përdoren për shërbim funeral	Në pronësi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
SEKTORI I PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASTEVE

RELACION

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN PËRFUNDIMTAR TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE TEK BASHKIA Durrës, PËR
NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ**

Përpara Këshillit Bashkiak
Këtu

Të nderuar këshilltarë!

Projekt vendimi që po ju paraqesim për shqyrtim, ka për qëllim fillimin e procedurave me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për transferimin përfundimtar dhe përditësimin e të dhënave, të pronës me nr. 50 dhe 52, të listës së transferimit, me emërtimin "Varreza".

Rezulton se me VKM-në nr. 538, datë 07.8.2012, "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Manëz, të Qarkut të Durrësit", është miratuar lista paraprake e pronave që transferohen në pronësi, ose në përdorim të ish Bashkisë Manëz, ku pjesë e listës së transferimit është dhe prona me emërtimin "Varreza", që mbajnë nr. 50 dhe 52 të listës së transferimit, me Fushë përdorimi "Prona që përdoren për shërbim funeral" (Varreza).

Ka rezultuar se të dhënat teknike, që pasqyrohen në formularin e inventarizimit, miratuar me VKM nr. 538, datë 07.8.2012, janë të ndryshme me gjendjen në fakt. Kështu, pas. me nr. 66/22, ZK 2590, me Numer liste të transferimit 50, në formularin e inventarizimit është e evidentuar me sip. 21790 m², dhe pas. me nr. 75, ZK 2065, është inventarizuar me sip. 60975 m², ndërsa bazuar në matjet në terren, si dhe në projektin e bashkisë me emërtimin "Përmirësimi dhe zgjerimi infrastrukturës së varrezave, Njësia Administrative Manëz", ka rezultuar se këto pasuri përfshijnë sipërfaqet e varrezave të disa fshatrave. Pasuria ku janë varrezat ekzistuese në fshatin Kuçok 1902.63 m² dhe varrezat e fshatit Kamas është me sipërfaqe 4220 m².

Nisur nga fakti se për fshatin Kuçok dhe Kamas bashkia ka miratuar një projekt me emërtimin, "Përmirësimi dhe zgjerimi infrastrukturës së varrezave, Njësia Administrative Manëz".

Pasuritë që preken nga projekti për fshatin Kuçok janë pasuritë me nr.66/22, 67 dhe 287, ZK 2590, ndërsa pasuritë që preken nga projekti për fshatin Kamerras janë 75,77/7 dhe 156, ZK 2065. Nga informacioni i marrë nga ASHK-ja, Durrës, për pasuritë që kërkohen të transferohen rezultojnë se janë me gjendje juridike "Shtet", dhe se në këto pasuri nuk ka cënim të të drejtave të pronësisë të subjekteve, sipas përcaktimit që i bën neni 36, i ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", si përparësia e proceseve të tjera kalimtare të parashikuara. Të dhënat e pasqyruara në kartelën e pasurisë nuk kanë asnjë shënim që të bëjnë fjalë me përcaktimet dhe kufizimet që bën fjalë neni 36 dhe 37, i ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", dispozita të cilat i japin prioritet pasurive pronë private në raport me pasuritë me status "Shtet". Me asistencën e përfaqësuesit të ASHK-së, Durrës, janë identifikuar 6 (gjashtë) pasuri që do t'i ligjor dhe të pasurive kufitare me pronën objekt shqyrtimi, nga ku ka rezultuar se kufitarë me pronën me emërtimin "Varreza" me nr pas.66/22 për të cilën kërkohet transferim dhe përditësim janë pasuritë me nr 67 dhe 287 ZK 2590 Kuçok. Të dhënat e mësipërme janë marrë nga kartelat e pasurive të ardhura nga ASHK, Durrës, me datë 28.5.2025, të vulosura elektronikisht. Sipërfaqja e përgjithshme e pasurive që kërkohet të transferohen në pronësi të Bashkisë Durrës, për Njësinë Administrative Manëz, për t'u përdorur për varreza për fshatin Kuçok, ZK 2590 është 5396,704 m². Për fshatin Kamerras ku ka rezultuar se kufitarë me pronën me emërtimin "Varreza" me nr pas 75 për të cilën kërkohet transferim dhe përditësim janë pasuritë me numër 77/7 dhe 156 Zk 2065 Kmerrras. sipërfaqja për t'u përdorur për varrezat në fshatin Kameras, ZK 2065, është 4788,85 m².

Sqarojmë këshilltarët se referuar ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", si dhe bazuar në orientimet e ASHK-së, drejtoria që merret me inventarizimin dhe transferimin e pronave publike nga shteti në njësitë e vetëqeverisjes vendore, pasuritë që kërkohen të transferohen dhe përditësohen, që i përkasin Njësisë tashmë të shkrire Manëz, do të marrin numrin progresiv që i përkasin nr. 1844-1849 të listës së transferimit, miratuar me VKM nr. 536, datë 01.5.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Durrës, të Qarkut të Durrësit", i ndryshuar.

Për të sistemuar mospërputhjen e krijuar, kërkohet që të ndërmerren hapat ligjore për ndryshimet në sipërfaqen e pronës, pozicionimin, duke u bazuar në ligjin nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", ku neni 37 e vijues i ligjit, përcakton se: "... Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre. Procedura e përditësimit mbështetet në:

a) verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së;

b) verifikimin e gjendjes juridike të pronës. Institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore i kërkon ASHK-së informacion për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligj....". Ligji përcakton se në përfundim të këtyre verifikimeve, institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore i paraqet për shqyrtim ASHK-së listën e pronave shtetërore të përditësuar, pjesë e detyrueshme e së cilës është dokumentacioni hartografik. Në përfundim të përditësimit, ASHK-ja harton projektvendimin për miratim të listës përfundimtare të pronave shtetërore nga Këshilli i Ministrave. Pronat e përditësuara regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e listës përfundimtare të pronave shtetërore. Përditësimi kryhet edhe individualisht, për një ose më shumë prona të listës së pronave shtetërore (përditësim i pjesshëm) si më poshtë: a) nga ASHK-ja, kryesisht, gjatë procedurave të regjistrimit fillestar ose përmirësimit apo përditësimit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme të zonës kadastrale; dhe b) me nismë të institucionit shtetëror ose njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas nevojave të tyre...". Sqarojmë këshilltarët se përditësimi i pasurive objekt shqyrtimi është kryer në prezencë dhe në mbështetje të përfaqësuesit të ASHK-së, Durrës, si një detyrim dhe përcaktim i parashikuar nga ligji nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". Nga ana e strukturës së bashkisë, që merret me menaxhimin e pronave të paluajtshme, janë ezauruar të gjitha procedurat e parashikuara në ligj. Kështu, është marrë konfirmimi nga ASHK-ja Durrës për gjendjen juridike të pasurive objekt shqyrtimi, nga ku ka rezultuar se pasuritë e kërkuara për transferim dhe përditësim, janë me gjendje juridike "Shtet" dhe me shenimin Varreza. Pjesë e këtij projektvendimi është dhe informacioni për gjendjen juridike të pronës objekt shqyrtimi dhe planrilevimi i pronës.

Të nderuar,

Kërkojmë miratimin për transferim dhe përditësim të gjashtë pasurive me emërtimin Varrezë, si dhe miratimin për transferim nga Shteti tek bashkia Durrës, për Njësinë Administrative Manëz të gjashtë pasurive me qëllim të vazhdimin të procedurave për miratim në Këshillin e Ministrave, që është i ngarkuar me ligj për të miratuar listën e pronave të paluajtshme publike, që i transferohen në pronësi ose në përdorim njësive të vetëqeverisjes vendore. Vendimi i dalë nga Këshilli i Ministrave përbën titull pronësie dhe që shërben ndërmjet të tjerave dhe për t'a regjistruar pronën në regjistrin kadastral publik dhe pajisjen me certifikatë pronësie. Bazuar në ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendor", i ndryshuar, VKM-në nr. 500, datë 14.8.2001, "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar, indicien për të marrë në shqyrtimi një akti administrativ, që

lidhet me pronat publike, të cilat kërkohet t'i kalohen në pronësi apo përdorim njësisë së vetëqeverisjes vendore, e ka këshilli bashkiak. Ndërsa të drejtën e transferimit të pronave në Njesitë e vetëqeverisjes vendore e ka Këshilli i Ministrave, ku pika 19 e VKM-së nr. 500, datë 14.08.2001, përcakton se: "... Këshilli i Ministrave miraton listën përfundimtare, të pjesshme ose tërësore, të pronave që u transferohen njësive të qeverisjes vendore, përfshi dhe kushtet apo kufizimet që u vihen, përkatësisht, për secilën pronë....".

Pjesë e këtij relacioni është:

- VKM-ja nr.538, datë 07.8.2012, "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Manëz, të Qarkut të Durrësit", së bashku me formularin e inventarizimit, të pronës objekt shqyrtimi, që kërkohet të transferohet.
- Plan rilevimi i pronës, i përditësuar.
- Formulari i përditësuar i pronës me emërtimin: "Varreza".
- Kartelë për pasurinë me nr. 66/22; 67; 287, zk 2590; dhe kartelat e pas. me nr. 75; 77/7; 156, ZK 2065, ardhur nga ASHK, Durrës, e vulosur elektronikisht me datë 28.5.2025, së bashku me HTR.
- Projekti me emërtimin: "Përmirësimi dhe zgjerimi infrastrukturës së varrezave, Njësia Administrative Manëz".
- Detyrë projektimi me objekt: "Përmirësimi dhe zgjerimi infrastrukturës së varrezave, Njësia Administrative Manëz" e miratuar.

**SEKTORI I PRONAVE PUBLIKE
DHE MENAXHIMIT TË ASTEVE**

Pranvera Gagani

